

**VENDIM**  
**Nr. 501, datë 13.9.2017**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË  
SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Misioni i Ministrisë së Mbrojtjes është hartimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë së pavarësisë dhe të mbrojtjes së tërësisë territoriale të vendit, si dhe rendit të tij kushtetues, në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi, angazhon Forcat e Armatosura në përballimin dhe eliminimin e pasojave të ardhura nga emergjencat civile, si dhe në ndihmë të institucioneve shtetërore dhe komunitetit.

4. Vendimi nr. 947, datë 30.9.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**